

1	Malli i patundshëm: objekti afarist, i cili gjendet në rr. Hristijan Todorovski Karposh nr.5 Shkup – Çair; PK 570 KK Çair, kati: përdhese, hyrja 2, dedikimi: Hapësirë afariste me sipërfaqe prej 103 m ² .	2.450,00	252.324,00	15.531.375,00	77.657,00	1553,14,00	12:00
---	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------	------------	---------------	-----------	------------	-------

(Në pajtim me Ligjin për shfrytëzimin dhe disponimin e mallërave në pronësi shtetërore dhe me mallrat në pronësi të komunës “Gz. Zyrtare nr. 78 dhe 153 të vitit 2015 lartësia e qiramarrjes fillestare mujore arrin 0,5% nga vlera e vlerësuar e pronës së patundshme)

3. Data e mbajtjes së ankandit publik

Ankandi publik do të mbahet me datë **16.03.2018 (e hënë) me fillim në ora 12:00.**

Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në këtë ueb faqe të internetit [www.http://cair.gov.mk](http://cair.gov.mk)

4. Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik

. Të drejtë për pjesëmarrje në ankandin publik kanë të gjithë personat fizik dhe juridik të vendit dhe të huaj të cilët mund të arrijnë me pronësi të mallrave të lëvizshëm në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me Ligjin dhe të cilët i përmbushin kushtet e dhëna në shpallje

Shikimin i objektit i cili është lëndë e ankandit publik, subjektet e interesuara mund ta bëjnë në Komunën e Çairit me datë 06.03.2018 në periudhë prej ora 10 deri më ora 14.

5. Kushtet për pjesëmarrje në ankandin elektronik publik

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankandin publik (në formë të shkruar, në të cilën është shënuar cilat dokumente janë pjesë përbërëse e fletëparaqitjes), të kompletuar me këto dëshmi **(të bashkangjitur në origjinal ose të fotokopjuar të verifikuar në noter):**

1. **Fletëparaqitja nga parashtruesi**, në të cilën janë shënuar të dhënat të cilës i përket e njëjta, si dhe çka dorëzohet në shtojcë të fletëparaqitjes (cilat dokumente);
2. Dëshmi për garanci bankare për seriozitet të ofertës në lartësi prej 2% nga vlera e vlerësuar e mallit të lëvizshëm, Pagesa të bëhet në llogari të kasafortës : 100000000063095; Banka e pranimit BPRM; emri dhe selia e pranuesit Buxheti i Komunës së Çairit, llogaria e pagesës: 840-183-06548 , shifra hyrëse: 731117, programi 00
3. Për **persona fizik** letërnjoftimi ose dokumenti i udhëtimit;
4. Për **persona juridik** dëshmi për regjistrim të personit juridik nga regjistri përkatës;
5. **Autorizim në mënyrë të rregullt për të autorizuarin** i cili e përfaqëson personin juridik, gjegjësisht dëshmi për vetinë e personit të autorizuar përgjegjës të personit juridik dhe
6. E-mail adresa e parashtruesit të fletëparaqitjes, nëpërmjet të së cilës do të kryhet procedura për regjistrim për pjesëmarrje në ankandin elektronik publik, gjegjësisht do ti dorëzohen në afat prej tre ditëve nga dorëzimi i ofertës, emri i shfrytëzuesit

dhe shifra për pjesëmarrje në ankand publik gjegjësisht qasje në faqen e internetit në të cilën do të zhvillohet ankandi elektronik publik .

Flete pronësitë të cilat nuk janë të kompletuara me këtë dëshmi nuk do të marrin pjesë në ankandin elektronik publik për të cilën do të njoftohen në mënyrë elektronike. (për parashtuesit e fletëparaqitjeve të cilët do të dorëzojnë email adresë të gabuar, Komuna e Çairit nuk do të ketë obligim ti pranojë dhe të bëjë korrigjimin e të njëjtës).

Parashtuesit e fletëparaqitjeve është e nevojshme të dorëzojnë në fletëparaqitjen për pjesëmarrje në ankandin elektronik publik edhe fotokopje të llogarisë personale të transakcionit në të cilën do të mund ti kthehen depozitë për pjesëmarrje në ankandin publik.

6. Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve

Afati për dorëzimin e fletëparaqitjeve për pjesëmarrje në ankandin publik është 10 ditë nga dita e shpalljes së konkursit, përmbyllur me datë **12.03.2018 deri në ora 15.00.**

7. Garancia bankare

Garancia bankare për seriozitet të ofertës për pjesëmarrje në ankandin publik i kthehet parashtuesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik ndërsa garancia bankare e ofertuesit më të volitshëm i kthehet në afat prej 15 ditëve nga dita e pagesës së shumës së përgjithshme të arritur në ankandin publik.

8.Procedura

Ankandi publik fillon me shpallje të çmimit të qiramarrjes fillestare mujore të hapësirës afariste e cila është lëndë e ankandit publik dhe realizohet në mënyrë të ankandit nga ana e pjesëmarrësve.

Ankandi publik do të mbahet edhe nëse pas shpalljes është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili i përmbush kushtet e dhëna në shpallje dhe e jep çmimin fillestar .

Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund të pranojnë gjegjësisht ta rrisin çmimin e qiramarrjes mujore.

Ankandi publik llogaritet si i përfunduar në momentin e kalimit të afatit kohor të caktuar në shpalljen, gjatë së cilës përderisa me kalimin e dy minutave të fundit nga koha e caktuar për zgjatje të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë oferta, afati përfundimtar për mbarimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta ndërsa do të përfundojë kur për periudhën prej dy minutave të ardhshme nuk do të paraqitet ofertë tjetër.

Ankandi publik vazhdon pakufi, derisa në interval kohor prej dy minuta ka ofert të re nga pjesëmarrësit në ankandin publik, vlera e qiramarrjes mujore zvogëlohet për 2 % nga vlera e vlerësuar për çka pjesëmarrësit në ankandin publik përsëri kanë mundësi që ta pranojnë gjegjësisht rrisin çmimin e qiramarrjes mujore pa u kufizuar pastaj hapi minimal i rritjes.

Nëse në skadimin e dy minutave të fundit të pesë minutave të dyta nga ankandi publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, gjegjësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për mbarimin e ankandit publik vazhdohet edhe për dy minuta, kurse do të përfundoj në periudhë prej dy minutave të ardhshëm nuk do të jepet ofertë e re. Nëse në kohëzgjatje prej pesë minutave përsëri nuk ka oferta, vlera e qiramarrjes mujore, përsëri zvogëlohet për 2% nga vlera fillestare.

Për ofertues më të volitshëm llogaritet pjesëmarrësi në ankand publik i cili ka ofruar çmim përfundimtar i cili paraqet çmim më të lart.

Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përpilon procesverbal për ankandit publik të realizuar i cili dorëzohet tek të gjithë pjesëmarrësit në ankand publik.

Pjesëmarrësit kanë të drejtë të Ankohen vetëm në lidhje me procedurën për ankandin publik, në afat prej tre ditëve nga dita e mbajtjes së ankandit publik deri te komisioni i cili vendos ndaj ankesës me Aktvendim në afat prej 5 ditësh nga pranimi i ankesës.

Ofertuesi më i volitshëm në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim për zgjedhje është i obliguar që ti paguaj mjetet në pajtim me çmimin e arritur përfundimtarë për qiramarrje mujore, ndërsa nëse nuk i paguan në këtë afat nuk do të lidhet kontratë, garancia bankare do të jetë e aktivizuar, ndërsa ofertuesi në periudhë prej një viti nuk do të mundet të merr pjesë në secilin ankand publik të ardhshëm për dhënie me qira të mallit të patundshëm.

Me ofertuesin më të volitshëm në afat prej pesë ditë pune pas kryerjes së pagesës të çmimit të qiramarrjes mujore, lidhet kontratë për dhënien me qira të mallit të patundshëm.

Detyrimi për shpenzimet për solemnizim të kontratës bien në barrë të blerësit.

Kjo shpallje do të shpallet edhe në WEB e Komunës së Çairit [www.http://cair.gov.mk](http://cair.gov.mk)